

BESIMI ILIR NË ISTRIA: NJË ANALIZË E IDENTITETIT DHE KULTIT

(Peter Štoka, *Hyjnitë ilire në Istria: identitet dhe kult,*
Organizata Iliria, Kopër, Slloveni, 2023)

Studimi i periudhës antike, veçanërisht i aspekteve që lidhen me kulturën dhe identitetin shpirtëror të popullsisve autoktone përbën një sfidë të veçantë për shkencat historike dhe arkeologjike. Fragmentariteti i burimeve, mungesa e të dhënave të plota dhe ndikimet kulturore të mëvonshme, që shpesh i janë mbivendosur shtresimeve indigjene, e bëjnë dukshëm më të vështirë rindërtimin e një tabloje të qartë dhe koherente të jetës shpirtërore të popujve indigjenë. Megjithatë, ndërthurja e dëshmimeve të shkruara nga autorët antikë me të dhënat e nxjerra nga gërmimet arkeologjike ka mundësuar që, gjatë dekadave të fundit, të ofrohet një kuadër më i qëndrueshëm mbi historinë dhe kulturën e ilirëve.

Në vazhden e këtij interesimi në rritje për dimensionet shpirtërore dhe religjioze të ilirëve, një vend të veçantë zë analiza e praktikave religjioze dhe adhurimi i hyjnive, si mënyra të rëndësishme për të kuptuar strukturat e besimit dhe formësimin e identitetit të tyre. Në këtë drejtim, vepra "*Hyjnitë ilire në Istria: identitet dhe kult*" e studiuesit slloven Peter Štoka, përbën një kontribut të çmuar dhe origjinal, pasi ofron një analizë të hollësishme mbi hyjnitë që nderoheshin dhe adhuroheshin në trevën istriane, duke ndriçuar kësaj një aspekt të lënë në hije të botës shpirtërore ilire të kësaj treve.

Duke u mbështetur në studimet paraprake, të dhënat epigrafike dhe referencat e autorëve antikë, autori ofron një analizë të hollësishme për të plotësuar tablonë e njohurive mbi panteonin ilir. Kontakti i ilirëve me qytetërimet greke dhe romake ka ndikuar ndjeshëm në kulturën e tyre, përfshirë botën shpirtërore, një dimension të cilit autori i kushton vëmendje të veçantë, duke analizuar mënyrat se si ky ndikim është reflektuar në praktikat fetare dhe përfaqësimet hyjnore. Kjo ndërthurje kulturore bëhet veçanërisht e dukshme në dëshmitë epigrafike, ku vërehet se, pas pushtimit romak, ilirët filluan të ngrinin monumente kushtuar hyjnive të tyre, duke ruajtur emrat origjinalë të disa prej tyre dhe duke i identifikuar ato me perënditë romake përmes procesit

të njohur si *interpretatio romana*. Kësisoj, sinkretizimi i disa kulteve vendore me ato romake pasqyron një ndërveprim kompleks dhe shumëplanësh midis traditave lokale dhe ndikimeve perandorake.

Brenda mozaikut të pasur të besimeve ilire në Istrinë dhe Liburninë antike, në veprën e tij autori Štoka ndalet me kujdes te një sërë hyjnish që përfaqësojnë shtresime të ndryshme të jetës shpirtërore vendase, si Histria, Boria, Ika, Trita, Iria dhe Eia. Ai shqyrton gjithashtu disa hyjni të tjera më pak të njohura, si Nebribus, Zane (Sentone dhe Rizone) dhe Melozocus, të dokumentuara përmes burimeve epigrafike dhe toponimisë lokale të Istriasë. Për secilën prej këtyre hyjnive, autori analizon origjinën, atributet dhe format e adhurimit, duke ndriçuar hapësirën e tyre gjeografike dhe rolin që ato luanin në jetën shpirtërore të popullsisë ilire të kësaj zone. Një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe mënyrës sesi këto hyjni vazhduan të adhurohen edhe pas pushtimit romak, duke reflektuar kësaj qëndrueshmërinë e identitetit ilir përmes praktikave të trashëguara fetare.

Në aspektin metodologjik, autori ka preferuar një qasje të thjeshtë dhe funksionale, që shmang ndarjen klasike në kapituj të rreptë dhe ndjek një rrjedhë më të natyrshme në trajtimin e materialit. Kjo strukturë më fleksibile i mundëson të paraqesë një pasqyrë të qartë dhe koherente, me fokus te identiteti i hyjnive ilire dhe praktikat fetare të banorëve vendas. Vëmendje e veçantë i kushtohet mungesës së informacionit të mjaftueshëm mbi kohën dhe rrethanat e formimit të këtyre kulteve, ndërsa autori nxjerr në pah boshllëqet që vazhdojnë të jenë të pranishme në literaturën shkencore mbi këtë temë.

Përfundimi kryesor që del nga ky studim është se, pavarësisht ndikimeve të qytetërimeve të huaja, ilirët e Istriasë ruajtën një lidhje të fortë me traditat e tyre fetare, duke adhuruar hyjnitë autoktone në forma të ndryshme, qoftë të sinkretizuara apo të përshtatura sipas modelit romak. Në këtë kontekst, theksohet se politika tolerante e Romës ndaj besimeve indigjene ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e vazhdimësisë kulturore dhe identitetit të ilirëve. Si rezultat, kjo plejadë hyjnish ilire vazhdoi të adhurohej dhe të mbetej e pranishme deri në përhapjen e krishterimit, duke dëshmuar qëndrueshmërinë e praktikave fetare tradicionale përballë ndryshimeve të mëdha kulturore.

Studimi i autorit Štoka paraqet një kontribut të vyer për historinë antike dhe arkeologjinë, duke ofruar një analizë të argumentuar mbi dimensionin religjioz të ilirëve në Istrinë antike. Vepra jo vetëm pasuron literaturën mbi kulturën shpirtërore ilire, por gjithashtu shërben si një pikënisje e dobishme për kërkime të mëtejshme në këtë fushë. Si e tillë, ajo i flet si publikut të gjerë

të interesuar në historinë e lashtë, ashtu edhe studiuesve që kërkojnë të thellojnë njohuritë mbi kultet vendore dhe identitetin fetar të ilirëve.

Përgjithësisht, vepra “*Hyjnitë ilire në Istria: identitet dhe kult*” është një përpjekje e suksesshme për të ndriçuar aspekte specifike të besimeve fetare të ilirëve në këtë rajon. Ky studim përbën një kontribut domethënës në pasurimin e literaturës ekzistuese dhe shërben si pikënisje e vlefshme për thellimin e njohurive mbi rolin e religjionit në ndërtimin e identitetit kulturor ilir. Në këtë kuadër, kontributi i Peter Štoka-s meriton vlerësim të veçantë për ndihmesën që jep në ndriçimin e historisë dhe kulturës së ilirëve të Istriasë.

Emine HAJDARI

